



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 01.10.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërtim i markatës, në Njësinë Administrative Manëz”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punime ndërtimi - 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 28,268,828.61 (njëzet e tetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzet e tetë pikë gjashtëdhjetë e një) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr.302, datë 25/09/2025 me Nr.11423 protokollin, të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumentet sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2025 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i projektimit në Bashkinë Durrës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës në bazë të urdhrit Nr.302, datë 25/09/2025, me Nr.11423 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr.216, datë 13.4.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 28,268,828.61 (njëzet e tetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzet e tetë pikë gjashtëdhjetë e një) Lek pa TVSH.

Projekti do financohet në dy vite të ndarë, për vitin 2025 dhe 2026 nga buxheti i bashkisë dhe Minsistria e Bujqësisë.

Afati i realizimit të punimeve është, 6 (gjashtë) muaj, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve ,që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 1 vit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, neni 43, pika 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e kopjes të

deklarimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", nenin 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare: (2022, 2023, 2024), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Kërkesa për paraqitjen e balanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti i tij) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: *Kriteri i përvojës së mëparshme të ngjashme është përcaktuar në përputhje me: Nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili autorizon autoritetin kontraktor që, në funksion të natyrës dhe kompleksitetit të kontratës, të vendosë kritere mbi përvojën teknike të*

operatorëve ekonomikë, për të garantuar aftësinë reale të tyre në realizimin e kontratës; Nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor mund të kërkojë: punë të ngjashme për një objekt të vetëm, me vlerë jo më të madhe se 50% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit; ose punë të ngjashme me vlerë monetare totale jo më të madhe se dyfishi i fondit limit të kontratës së re.

Dispozitat ligjore nuk vendosin një detyrim për përdorimin e vlerave maksimale, por përcaktojnë kufijtë e sipërm brenda të cilëve autoriteti kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kriteret. Proporcionaliteti dhe mosdiskriminimi: Kriteri është hartuar duke lejuar dy alternativa (ose 50% e një kontrate të vetme, ose dyfishi i fondit limit në disa kontrata të ngjashme), duke shmangur kufizimin vetëm tek operatorët e mëdhenj ose vetëm tek operatorët me eksperiencë fragmentare. Ky fleksibilitet rrit konkurrencën dhe siguron proporcionalitetin, pasi i jep mundësi një game më të gjerë operatorësh që kanë përvojë reale të kualifikohen. Aftësia organizative dhe teknike: Ndërtimi i një markate (objekti i kontratës) është një punë publike me kompleksitet të veçantë, që përfshin jo vetëm ndërtim strukturor, por edhe instalime teknike, sisteme hidraulike, elektrike, dhe elementë funksionalë për shërbim publik. Për këtë arsye kërkohet që operatori të ketë demonstruar më parë aftësi të menaxhojë kontrata me natyrë dhe shkallë të ngjashme. Garanci për cilësinë dhe realizimin në afat: Duke kërkuar një përvojë minimale të ngjashme në vlerë dhe në kohë (5 vitet e fundit), autoriteti kontraktor merr garanci që operatori është i përditësuar me teknologjinë, normat teknike dhe standardet aktuale në ndërtim. Ligjshmëria: Vlerat e përcaktuara në këtë kriter nuk e tejkalojnë kufirin maksimal të parashikuar nga ligji, por vendosen në kufirin më të lartë të lejuar. Kjo është e justifikuar nga natyra e veçantë e objektit dhe rëndësia e tij për komunitetin lokal (ndërtimi i një markate me funksione publike). Dokumentimi i përvojës: Kërkesa për vërtetime nga autoritete publike ose private, të shoqëruara me fatura tatimore dhe dokumente të tjera të ligjshme, është në përputhje me nenin 39 të VKM nr. 285/2021, duke garantuar që përvoja e pretenduar është reale, e verifikueshme dhe e deklaruar në organet tatimore.

Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP – 1A Punime gjurmimi në tokë;
- NP – 4A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;
- NP – 7A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje;
- NP – 11A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë;
- NP – 12A Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit:

- NS – 1A Punime për prishjen e ndërtimeve;
- NS – 2A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre;
- NS – 4A Punime rifiniture te muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;
- NS – 8A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri;
- NS – 14A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj;
- NS – 18A Punime topogjeodezike;

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit ne fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr.92, datë 19.02.2014 ku janë të përcaktuar kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licencat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari ne fushën e ndërtimit.

Pikat e licencave janë përcaktuar ne baze te zërave te përshkruara ne preventivin e projektit. Niveli i Shoqërisë sipas vlerave ne leke te punimeve te kryera për çdo kategori.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kerkua	Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes	Zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese	Niveli i klasifikimit i kerkuar per kategorine respektive	Vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese
NP-1	Punime gërmimi ne toke.	Punime për gërmime, sistemime dhe ndryshime ne volum te tokës, te realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit qe do te gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte, etj	A (196,567.50)	0 ÷ 20 milion

NP – 4	Rruge, austostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	Punime ndërtim rruge, punime te mureve mbajtëse, si dhe komplekse karakteristikash teknike, ne hekur, betonarme te thjeshte dhe te paranderur, parafabrikat ose te prodhuar ne objekt. Te gjithë zërat e preventivit te ndërtimit te objektit përfshihen ne këtë pike.	A (3,914,098.68)	0 ÷ 20 milion
NP – 7	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	Ndërtime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin e shërbimit hidrik kompleks. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e ujësjellësit, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, etj.	A (639,765.86)	0 ÷ 20 milion
NP – 11	Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	Ndërtime me ndërhyrje në rrjetin e furnizimit me energji elektrike që janë të nevojshme për realizimin e shërbimit hidrik kompleks.	A (484,040.85)	0 ÷ 20 milion
NP – 12	Punime te inxhinierisë se mjedisit	Përfshin ne mënyrë te thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, konservimin dhe riaftësimin e terrenit te përdorur. Veprat për rivegjetizimin e skarpateve te zonës ku është parashikuar ndërtimi i mureve me toke te armuar, mbrojtja e skarpateve, etj.	A (84,999.36)	0 ÷ 20 milion
NS – 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Përfshin ne mënyrë te thjeshtuar prishjet ne përgjithësi te strukturave ekzistuese prej guri e betoni, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave.	A (38,879.02)	0 ÷ 20 milion
NS – 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Perfshin ne menyre te thjeshtuar punimet e mbrendeshme hidrosanitare	A (723,065.60)	0 ÷ 20 milion
NS – 4	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metali dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	Punime per ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.	A (15,770,371.7)	0 ÷ 20 milion
NS – 8	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	Perfshin prodhimin ne rruge industriale dhe montimin ne veper te strukturave parafabrikate prej betoni te armuar, te paranderur.	A (5,523,543.28)	0 ÷ 20 milion
NS – 14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	Punime per ndertimin e Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	A (339,205.91)	0 ÷ 20 milion
NS – 18	Punime topogjeodezike	Konsiderohet zbatimi i punimeve topogjeodezike ne objekte inxhinierike.	A	0 ÷ 20 milion

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|--------------------------|---------|
| a. Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| b. Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| c. Inxhinier Gjeodet | 1 (një) |
| d. Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| e. Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |

Në rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik,

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licencës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve me qëllim realizimin saktë tëzërave të parashikuar në projekt si punime.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve KUB te parashikuar në projekt.
- **Inxhinieri i Elektrik** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve elektrike te parashikuara ne projekt.
- **Inxhinieri Gjeodet** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve KUB ne rilevimin e terrenit te parashikuar në projekt.
- **Inxhinier Mjedisi**, Referuar në preventivin e Punimeve paraprake si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP12.

Shënim: Bazuar ne Rekomandimin Nr.6732, date 21.10.2020 ”Mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”, inxhinierët e mësipërm duhet te vetdeklarojne se ata janë te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet;

a) Kontrata e punës e vlefshme dhe

b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.*

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licencës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më

vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, të figurojnë në listëpagesat e (3) tre muajve të fundit konkretisht:

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Për përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: • Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e (3) tre muajve të fundit.
- b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë si "Ekspert për Ndihmën e pare dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave" nga kryqi i kuq ose organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: • Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e (3) tre muajve të fundit.
- c. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë Për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve" lëshuar nga organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: • Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e (3) tre muajve të fundit.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” bazuar në përlogaritjen e oreve të punës, kategorite të punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve, të cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik të kërkuar nga AK, si edhe bazuar në dosmosdoshmerine të realizimit sa më shpejt të objektit.

- Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri të përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos në këtë kontratë ku dhe numri i punonjësve të kërkuar për realizimin e saj është i lartë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”
- Kërkesa për punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikatë. Natyra e kontratës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.
- Kërkesa për punonjës “Specialist për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve të Ndërtimit”, është një masë e arsyeshme dhe e domosdoshme për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve të ndërtimit. Testimi i performancës së produkteve të ndërtimit është një proces i rëndësishëm për të siguruar që materialet e përdorura në ndërtim përmbushin standardet e cilësisë dhe sigurisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të shmangur defekte strukturore dhe për të garantuar jetëgjatësinë e ndërtesave. Rregullorja e BE-së Nr. 305/2011 përcakton kushtet për vendosjen në treg të produkteve të ndërtimit dhe kërkon që performanca e tyre të vlerësohet sipas standardeve të harmonizuara. Kërkesa për një punonjës të certifikuar siguron që procesi i testimit të kryhet në përputhje me këto rregullore. Një certifikatë e tillë ndihmon në minimizimin e rreziqeve ligjore dhe financiare që mund të lindin nga përdorimi i

produkteve të ndërtimit me cilësi të ulët. Ky kriter jo vetëm që është i arsyeshëm, por edhe i domosdoshëm për të siguruar që produktet e ndërtimit të jenë të testuara dhe të certifikuara sipas standardeve më të larta

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Punonjës Staf Teknik

a. Teknik Ndërtimi (Diplome e shkollës mesme)	1(një)
b. Teknik i mesem Topograf (Diplome e shkollës mesme)	1(një)
c. Agronom/teknik i mesëm bujqësie	1(një)
d. Hidraulikë (Me Certificate Trajnimi / Diplomë)	1(një)
e. Karpentier (Me Certificate Trajnimi / Diplomë)	2(dy)
f. Hekurkthyes(Me Certificate Trajnimi / Diplomë)	2 (dy)
g. Betonues (Me Certificate Trajnimi / Diplomë)	2 (dy)
h. Saldator (Me Certificate Trajnimi / Diplomë)	1(një)
i. Hidroizolues/Punonjes Catie (Me Certificate Trajnimi / Diplomë)	1(një)
j. Shofer	2 (dy)
k. Punëtore ndërtimi te thjeshte	5 (pesë)

Punonjës Manovrator

a. Eskavatorist	1(një)
b. Automakinist	1(një)

Për këta punonjës, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- Dëshmi kualifikimi/certificate ose diplome e lëshuar nga Ministria e Financave ose te njihet nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale te paraqitet certificate/diploma profesionale për secilin. Certificatekat / diplomat duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”, i ndryshuar. Kjo kërkesë po ashtu është ne përputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik. Diplomat/certificatekat e paraqitura nga organizma te cilat nuk janë te licencuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumente te rreme te cilat përbejnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja ne prokurimet publike.
- Për teknik ndërtimi duhet, diplome nga institucionet e arsimit te mesëm profesional (publik/privat) te akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne RSH”.
- certificate te sigurimit teknik e lëshuar nga shoqëri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për punonjësit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës te vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR).
 - (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).
 - Për punonjësit Manovratorë duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor. Kërkesa për dëshmitë e manovratorëve bazohet në Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”
- (Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).
- Për punonjësit e krahut, ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme .

Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësoj Deklarata “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjesit e mesiperm **duhet të deklarojnë**: emer/mbierner, profilin e punes, subjektin leshues te certifikates/diplomes, Nipt (në rastin kur subjekt leshues i certifikates/diplomeseshte privat) dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr	Emer Mbierner	Profesioni	Data e fillimit te marredhenie ve t punes	Nr. Amzes/ ekuivalent diplomes/ certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data e vlefshmerise se certifikates profesionale
----	---------------	------------	---	---	------------------------------------	--

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi

kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

- **Teknik Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu organizimin dhe kontrollin e grupeve të angazhuara për të siguruar cilësinë e punimeve në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Tekniku topograf** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit në ndërtimet e reja që do të kryhen duke asistuar drejtuesin teknik. Tekniku duhet të disponojë Diplome të shkollës mesme.
- **Agronom/teknik i mesëm bujqësie** janë të nevojshëm për punimet mjedisore si mbjellja e pemëve, etj...
- **Hidraulikët:** Hidraulikët janë të nevojshëm për të garantuar instalimin e sistemeve të kanalizimit të ujërave të ndotura, përfshirë montimin e tubacioneve, kontrollin e pompave, dhe sigurinë e rrjedhës së ujit.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona të soleta sipas zerave të preventivit. Bejnë piketimin dhe armaturen anësore të themelit, bejnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit, ndërtojnë armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojnë skelerine përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri të metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kerkuar është bazuar në grafikun e punimeve dhe volumit të punimeve. Karpentierët duhet të disponojë Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Hekurkthyesit** janë të nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin e zerave të punimeve të hekur betonit sipas preventivit. Numri i kerkuar është bazuar në grafikun e punimeve dhe volumit të punimeve. Hekurkthyesi duhet të disponojë Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit sipas zerave të preventivit. Ndihmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do të derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj

peshës dhe presionit të ngarkesës beton, Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Betonues duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.

- **Saldator** nevojitet per realizimin e strukturave referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkelidhur projektit teknik te ndertimit eshte i nevojshem per te siguruar kryerjen me eficence te punimeve ne nr. e analizes 2.181, An2, etj.
- **Hidroizolues/Punonjes Catie** janë të nevojshëm për punimet e hidroizolimit sipas zerave te preventivit. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Hidroizolues duhet te disponoje Certificate Trajnimi / Diplome.
- **Manovratori eskavatorist** eshte i nevojshem per përdorimin e makinerive të renda te ndertimit si eskavator germimi dhe fadroma te te gjitha llojeve, te cilat jane kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketyre makinerive. Ne nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmime të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator gërmimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST.

- **Manovratori automakinist** eshte i nevojshem per përdorimin e makinerive të renda te ndertimit si autobetoniere, autovinca, autopompe betoni, te cilat jane kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketyre makinerive. Ne nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmime të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.

- **Shofer** pajisur me Certificate Aftesimi Profesional nevojitet per manovrimin e automjeteve te transportit, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkelidhur projektit teknik te ndertimit eshte i nevojshem per te siguruar kryerjen me eficence te punimeve
- **Punëtorët e thjeshtë të ndërtimit** janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin të objekti.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 28 persona, në listpagesa sipas formularëve standard për sigurimet, për 3 muajt e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumente të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ë fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve prej 28 punonjës përfshin, punëtorë të thjeshtë, persona janë stafi i kualifikuar inxhinierëve, person teknikë , person specializuar/të kualifikuar dhe person manovratore/shofere të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve si edhe kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur ne baze te volumeve te punës dhe grafikut te punimeve.

Referuar VKM nr.216 datë.13.4.2023, per “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve/makinerive/pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës.

Numri i punonjesve dhe qendrueshmeria e tyre ne pune me koheshtrirje 3 (tre) muajt e fundit tregon besueshmeri per autoritetin qe, operatori do te permbushe kontraten. Dëshmia e kërkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhenesit i parashikuar nga Kodi i Punes, per rrjedhoje vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e te punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë ne përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri te caktuar, përveç besueshmërisë se operatoreve ekonomik, si një nga kërkesat themelore te kualifikimit, përpigjet te kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet te paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion/ kontratë shërbimi operatorit ekonomik.

Kërkohen te jene ne dispozicion këto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamioncine me kapacitet mbajtes jo me shume se deri 1.5-3.5 Ton	Pronesi ose me qira	1 copë
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes (15 – 20) ton.	Pronesi ose me qira	1 copë
3	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Pronesi ose me qira	2 copë
4	Kamion me vinc me kapacitet mbajtes (20 – 22) ton pajisur me vinc me krah jo me pak se 12 m dhe kapacitet ngrites jo me pak se 4 ton.	Pronesi ose me qira	1 copë
5	Rrul gome hekur mbi 15 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
6	Rrul asfalt hekur hekur mbi 10 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
7	Rrul për bankina mbi 2 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
8	Fadrom me goma me kovë para mbrapa	Pronesi ose me qira	1 copë
9	Ekskavator me zinxhire me peshe jo me te vogel se 20 ton i pajisur me matrapik per prishje struktura	Pronesi ose me qira	1 copë
10	Ekskavator me zinxhire me peshe jo me te vogel se 7 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
11	Ekskavator me zinxhire me peshe jo me te vogel se 2 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
12	Autobetoniere me peshe jo me te vogel se 30 ton	Pronesi ose me qira	2 copë
13	Autopompe betoni me krah jo me te vogel se 15 m, per betonimin e strukturate te ures	Pronesi ose me qira	1 copë
14	Dumper kantieri vetshkarkues me peshe jo me te vogel se 2.5 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
15	Rimorkiator per levizjen e makinerive te ndertimit me kapacitet mbajtese jo me pak se 20 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
16	Pajisje per dedektim rrjetesh ekzistuese nentokesore	Pronesi ose me qira	1 copë
17	Instrument Topografik (Stacion Total, GPS)	Pronesi ose me qira	1 copë
18	Vibrator betoni	Pronesi ose me qira	2 copë
19	Moto pompe uji	Pronesi ose me qira	1 copë
20	Matrapik	Pronesi ose me qira	1 copë
21	Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndertimit	Pronesi ose me qira	1 copë
22	Tokmak	Pronesi ose me qira	2 copë
23	Betoforma / Kalleperi derrase	Pronesi ose me qira	400 m2
24	Skeleri	Pronesi ose me qira	400m2
25	Karroca dore	Pronesi ose me qira	5 copë
26	Gjenerator / Motogjenerator	Pronesi ose me qira	1 copë
27	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	Pronesi ose me qira	1 copë
28	Kulle Ndricimi	Pronesi ose me qira	1 copë

29	Aparart saldimi MIG TIG	Pronesi ose me qera	1 copë
----	-------------------------	---------------------	--------

- Pajisje te tjera ndihmese, (te cilat duhet te vërtetohen me deklarate sipas shtojcës përkatëse, te DST:

Nr	Mjete mbrojtëse	Njësia	Sasia
1	Kuti e ndihmës se shpejte	cope	1 copë
2	Tabela sinjalistike e përkohshme për menaxhim trafiku	cope	10 copë
3	Helmata pune, kokore	cope	15 copë
4	Jelek pune fosforeshent	cope	15 copë

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatë për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti.
- Për mjetet e marra me qira që shënohen në regjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikata për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Kurse për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Për të gjithë mjetet dhe pajisjet e kërkuara te shoqërohen me foto.

Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “d” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushës. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë

të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me liçense lëshuar nga QKL: "Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane", "Kodi III.2.B", së bashku me aktin e miratimit.

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B). Kërkesa e mësipërme është referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu.), prishje struktura dhe shtresa prej betoni, prishje (mur tulle, shtresa etj.), dhe kryerjen e transportit të tyre në vend depozitimit e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licensimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 "Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". "Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme".

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata

- a. Çertifikaten e menaxhimit të cilesise ISO 9001:2015 e vlefshme ose ekuivalent.
- b. Çertifikaten e menaxhimit të sigurise në transportin rrugor ISO 39001:2012 e vlefshme ose ekuivalent.
- c. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të mjedisit (ISO 14001:2015) e vlefshme ose ekuivalent.
- d. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të shendetit dhe sigurimit në punë (ISO 45001:2018) e vlefshme ose ekuivalent
- e. Certifikatën SSH EN ISO 3834-2:2021, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent. (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise në Saldim e vlefshme ose ekuivalent

Certifikatat si me siper duhet te paraqiten origjinale ose kopje te noterizuara, te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, si dhe nenit nr. 79 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-se Nr.285, date 19.5.2021 i ndryshuar. Per vet natyren e vecante, vendndodhjes dhe permasat e objektit te kontrates qe do te prokurohet, eshte teper e rendesishme qe operatoret si zbatues, te kryejne veprimtarine me standardet e kerkuara te cilesise. Sistemi i menaxhimit te cilesie, mjedisit dhe shendetit dhe sigurise ne pune jane standarte qe cdo subjekt juridik apo privat e ka qellim ne arritjen e suksesit. Keto certifikata lidhen ngushtesisht me objektin e kontrates persa kohe do te pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e kapaciteteve te operatoreve ekonomike dhe te mundesise se tyre per permbushjen e plote te kontrates. Referuar ne nenin 79 te ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund te kerkoje certifikata, te leshuara nga organe te pavarura, qe vertetojne pajtueshmerine e kandidatit ose te ofertuesit me standardet e kerkuara te cilesise, perfshire edhe standardet per menaxhimin e mjedisit, shendetit dhe sigurise ne pune. Duke qene se perfituesi direkt i kontrates objekt prokurimi eshte Autoriteti Kontraktor, gazon te drejten per t’u garantuar se operatoret ekonomike pjesemarres i plotesojne kerkesat e cilesise per punet qe do te kryhen, e rrjedhimisht eshte e drejte e ketij te fundit t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga organe te pavarura te njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombetar ose Nderkombetar”.

- Per ISO 9001 - 2015; Kjo certifikate specifikon kerkesat per nje sistem te menaxhimit te cilesise, ku nje operator ekonomik duhet te tregojte aftesine e tij qe vazhdimisht te siguroje pune/mallra ose sherbime qe plotesojne kerkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon te rrishte kenaqesine e konsumatorit nepermjet zbatimit efektiv te sistemit duke perfshire edhe proceset per permiresim te vazhdueshem te sistemit dhe sigurimin e konformitetit te klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqenese Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kerkon qe punimet qe do te kryhen te jene ne cilesine me te larte eshte percaktuar qe kandidatet ofertues te jene te pajisur me kete standart cilesie.

- Per ISO 39001:2012: Kjo certifikate specifikon kerkesat per nje sistem te Menaxhimit te Sistemit te Sigurise se Trafikur Rrugor (RTS) ISO 39001:2012 eshte standard per Sistemet e Menaxhimit te Sigurise Rrugore. Standardi nderhyn ne Menaxhimin e Sigurise se Transportit Rrugor permes nje politike te duhur, zhvillimin e objektivave dhe nje informacioni te efektshem dhe te komunikimit. Mund te permiresoje sigurine rrugore dhe te ule normen e aksidenteve dhe vdekshmerise. Standardi eshte nje mjet i dobishem per te ndihmuar kompanite dhe organizatat per te permiresuar jo vetem sigurine e punetoreve (me rrezik te madh kur ata jane ne rruge) por edhe te te gjitha perdorusve te tjere te rruges. Standardi mund te integrohet me standardet ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015..

- Per ISO 14001:2015: Kjo certifikate specifikon kerkesat per nje sistem te Menaxhimit mjedisor perfaqeson kalimin e drejtimit te kompanise nga vetem respektimin e ligjeve, ne nje

manaxhim te aktivitetit perkushtuar parandalimit te ndotjes dhe te permiresimit te ndikimeve mjedisore. Mbrojtja e mjedisit merr per cdo kompani nje rol gjithmone e me te rendesishem. Shumellojshmeria dhe shtimi i burimeve te ndotjes, kontrolli gjithmone e me I kujdesshem qe shtetet jane duke bere rreth temes se mjedisit dhe ashpersimi I denimeve per cilindo qe ndot mjedisin, tregojne qe eshte e nevojshme qe te veprohet.

- Per ISO 45001:2018: Kjo çertifikate specifikon kerkesat per nje nje instrument organizativ qe lejon manaxhimin ne menyre organike dhe sistematike te sigurise ne pune, duke theksuar kerkesat e meposhtme:

Adoptimi i nje politike per menaxhimin e sigurise;

Identifikimi i rreziqeve, vleresimi i tyre, identifikimi i metodave te kontrollit, te lidhura ngusht me rregullat ligjore ose masat e tjera;

Perkufizimi i programeve dhe objektiveve specifike duke zbatuar logjiken e Planit-Do-Check-Act;

- ISO 3834-2:2021 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues qe merr persiper punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilesise se ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të cojnë në carje të nyjeve.

2.4.3 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Konstruksione metalike te perbera
- Tulla te plota
- Hekur betoni
- Panele sandwich

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori ose marveshje bashkepunimi me prodhuesin/distributor i autorizuar. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore te kerkuara. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve , ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatat e cilesise ISO 9001: 2015 të prodhuesit/ve ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Operatori ekonomik bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një

jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontrates.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.4.4 Vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave, nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS

(Për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të parashikimeve ligjore të Kreut III, të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku parashikohet:

a) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t’u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencura kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkrone fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

2.4.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a. PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat teknikoorganizative dhe elementet e tjerë qe kërkon një plan organizimi i mirëfilltë.
- b. PLANIN E SIGURISE NE KANTIER për punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Për masat e veçanta te sigurimit dhe ruajtjes se shëndetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj..., dhe VKM Nr. 448, datë 31.7.2025 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit"

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 15 pika 3/a “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 është e lidhur me kërkesat teknike mbi mënyrën me grafikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit te punimeve.

2.4.6 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit

Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”

Grupi i hartimit të specifikimeve referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar nga projektuesi ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 6 (gjashtë) muaj pune nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.5 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike të përgatitura për objektin “Ndërtim i markatës në Njësinë Administrative Manëz”, janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor, në funksion të garantimit të realizimit të punimeve me cilësinë dhe standardet e kërkuara. Në përmbajtjen e tyre janë pasqyruar me kujdes sasi të nevojshme të punimeve dhe materialeve, karakteristikat teknike të duhura për secilin element ndërtimor, si dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi, duke u mbështetur në metodologjinë e matjes dhe përshkrimit të punimeve sipas CESMM4. Këto specifikime janë përgatitur në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton se dokumentet e tenderit duhet të përmbajnë kërkesa të qarta dhe të paanshme, të afta të sigurojnë konkurrencë të ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe realizimin e kontratës sipas kushteve teknike të nevojshme. Në këtë kuptim, specifikimet teknike nuk kufizohen vetëm në përshkrimin e materialeve dhe metodave të ndërtimit, por parashikojnë gjithashtu procedura kontrolli, testimi dhe dorëzimi, duke garantuar përputhshmëri me projektin ekzekutiv dhe me objektivat e investimit publik. Përmes tyre sigurohet jo vetëm transparenca dhe barazia në procesin e prokurimit, por edhe mbrojtja e interesit publik nëpërmjet ndërtimit të një objekti funksional, të sigurtë dhe me jetëgjatësi të garantuar. Në specifikimet teknike, AK i është referuar standardeve ndërkombëtare EN, fakti që ekzistojnë standard ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, vlerësojmë që për standardet e mësipërme, ne si AK

pranojmë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. Shënim: Në çdo kërkesë të preventivit ku është shënuar marka e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit